



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Agrobiznesit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Menaxhimi i mbeturinave bujqësore dhe të ushqimit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>O</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Ass. Milaim Musliu</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>milaim.musliu@unhz.eu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Ky modul përmban informacione bazike për studentet mbi mbeturinat, përbërjen dhe klasifikimin e tyre, studentet do të mësojnë për mbeturinat nga bujqësia dhe ushqimi, përbërja e tyre dhe menaxhimin e integruar si një zgjidhje për mbetjet ushqimore dhe bujqësore.</p> <p>Moduli fillon me një pasqyrë globale të problemit të mbetjeve ushqimore dhe bujqësore. Më pas vazhdon shtjellimin e temave të përpunimit të ushqimit dhe mbetjeve të tyre, që përdorin nënproduktet si burime të bioenergjisë, duke vazhduar shtjellimin e metodave për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve së bashku me praktikatat bazë dhe moderne mjedisore për menaxhimin e mbetjeve ushqimore dhe bujqësore. Kapitujt diskutojnë menaxhimin e mbetjeve ushqimore në lidhje me rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë mjedisore dhe strategjitë e menaxhimit që kompensojnë ndikimin e mbetjeve ushqimore dhe bujqësore në mjedis. Së fundi, trajtohen sfidat dhe mundësitë që lidhen me menaxhimin e mbetjeve ushqimore dhe bujqësore në mbarë globin.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Ky modul ka për qëllim që studentet të fitoj njohuritë të përgjithshme për mbeturinat. Gjithashtu studentet do të marrin njohuri bashkëkohore shkencore mbi parimet dhe praktikatat e menaxhimit të mbeturinave. Menaxhimi i drejt i tyre dhe mundësitë e përfitimit nga mbeturinat bujqësorë dhe të ushqimit.</p>
	<p>Me përfundimin e këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Identifikojnë mbeturinave bujqësore, ushqimore, dhe llojet e tyre.</li></ul>

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptojnë rëndësinë e menaxhimit adekuat të mbeturinave.</li> <li>• Identifikojnë problemet dhe rreziqet për mjedisin të shkaktuara nga mbeturinat.</li> <li>• Identifikojnë dhe njohin disa nga metodologjitë e deponimit dhe riciklimit të mbeturinave.</li> <li>• Identifikojnë sfidat globale në menaxhimin e mbetjeve ushqimore dhe bujqësore.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime pune seminarike	2	15	30
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,	2	1	2
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	/	20	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final.)	/	13	13
Projektet, prezantimet, etj.	/	/	/
<b>Totali</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërime, diskutime, punë seminarike, vizita në teren, punë praktike, teste, provim me shkrim, provimi përfundimtarë.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i parë: 30%</li> <li>• Vlerësimi i dytë 25%</li> <li>• Detyrat e shtëpisë seminar 10%</li> <li>• Vijimi i rregullt 5%</li> <li>• Provimi final 30%</li> <li>• Total 100%</li> </ul>		
<b>Literatura:</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Integrated Waste Management approaches for food and agricultural byproducts. Prof S K Singh, 2024</li> <li>• Agricultural Waste Management, Thelma Bosso, 2016</li> <li>• Agricultural and Food Waste: Analysis, Characterization, and Extraction of Bioactive Compounds and Their Possible Utilization. Montserrat Dueñas Patón, Ignacio García-Estévez, 2020</li> </ul>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analysis of the Quantity and Composition of Waste in the Peja District, Kosovo ( Musliu &amp; Bilalli et., al 2023)</li> </ul>		

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

<b>Java:</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet:</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrja, definimi i mbeturinave, llojet dhe klasifikimi i tyre.
<i>Java e dytë:</i>	Mbeturinat Komunale, gjenerimi dhe trajtimi i tyre.
<i>Java e tretë:</i>	Mbeturinat nga sektori i industrisë agroushqimore.
<i>Java e katërt:</i>	Mbeturinat nga bujqësia dhe blegtoria.
<i>Java e pestë:</i>	Mbeturinat nga tekstili, ambalazhimi dhe paketimi
<i>Java e gjashtë:</i>	Mbeturinat e rrezikshme dhe Medicinale.
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Vlerësimi i parë.</b>
<i>Java e tetë:</i>	Mbeturinat dhe shëndeti.
<i>Java e nëntë:</i>	Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë sfidat dhe perspektiva.
<i>Java e dhjetë:</i>	Përfitimet nga mbeturinat ( Komposti, energjia etj. )
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Riciklimi i mbeturinave.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vetëdijesimi mjedisor rreth mbeturinave.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Legjislacioni i mbeturinave.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Deponimi i mbeturinave dhe alternativat.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Vlerësimi i dytë.</b>

**Ushtrimet - Punë seminarike**

Në kuadër të ushtrimeve studentët do të kryejnë punën seminarike ku do të përfshihen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me mbeturinat dhe menaxhimin e tyre në aspektin teorik dhe praktik në Kosovë dhe botë. Secili student do të zgjedhë temën specifike, për të cilën ai do të mbledhë informacion nga artikujt shkencorë, raste studimore ode dhe praktika të ndryshme. Studentët, rezultatet e mbledhura të do ti analizojnë dhe bazuar në rezultatet e fituara do të shkruajnë një raport të detajuar. Në fund secili student do të prezantojë punën e tij para studentëve të tjerë.

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.